

Dokument politikash:

Harmonizimi i ligjeve të Kosovës për Industrinë e TI—ut me Standardet Evropiane

Gusht 2010

Përkrahur nga:



Përmbledhje

Pas hulumtimit të TVSH-së dhe Doganës për pajisjet e TIK-ut në vendet e rajonit, STIKK-u me përkrahjen e DFID-it ka iniciuar përpilimin e dokumentit të quajtur "Dokument Konsultativ" i cili do t'i prezantohet Qeverisë së Kosovës për të ofruar një mjedis më të favorshëm për zhvillimin e sektorit të TIK-ut.

Industria e TIK-ut në Kosovë

- Qeveria e Republikës së Kosovës deri më tani ka miratuar shumë ligje, urdhëresa administrative, politika dhe standarde, të cilat rregullojnë zbatimin e TIK-ut në institucionet qeveritare. ***Ligji për Telekomunikim*** vlen për të gjitha shërbimet e telekomunikimit dhe të gjithë ofruesit e shërbimeve të telekomunikimit në Kosovë. ***Ligji për Shërbimet e Shoqërisë Informative*** i cili i jep dokumenteve elektronike vlerë ligjore të njëjtë me dokumentet në letër, me qëllim të lehtësimit të aktiviteteve komerciale siç janë: e-Tregtia, e-Bank, e-Pagesat, e-Qeverisja, e-Prokurimi. ***Ligji për Procedurën Administrative*** rregullon ekzekutimin elektronik të aktiviteteve të administratës publike. Më tutje, është miratuar ***Ligji për Të Drejtat Autoriale dhe të drejtat të ngjashme*** dhe ***Ligji për Aktivitetet Hulumtuese Shkencore***, si dhe janë draftuar ***Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*** dhe ***Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Krimin Kibernetik*** të cilat janë duke u shqyrtuar për miratim nga qeveria.

Megjithatë, infrastruktura ligjore është e pamjaftueshme për të siguruar norma të pranueshme të depërtimit dhe shfrytëzimit të lirë të teknologjive moderne dhe "broadband" të komunikimit. Prandaj, një faktor kryesor qendror në zhvillimin e tregjeve të TI-së në një vend është politika e qeverisë në lidhje me **Tarifat Doganore dhe Tatimet për Mallrat dhe Shërbimet e TI-së**¹.

Përafrimi me Standardet Evropiane

¹ SHIH ARBEN ABDULLAHU, "RAPORTI I TREGUT TË TIK-UT NË KOSOVË: NDIKIMI I DOGANËS DHE TVSH-SË NË TREGUN E TIK-UT NË KOSOVË" STIKK [HTTP://208.116.30.215/REPOSITORY/DOCS/ICT%20TRADE%20REPORT.PDF](http://208.116.30.215/REPOSITORY/DOCS/ICT%20TRADE%20REPORT.PDF)

- Duke kuptuar nevojën për politika më proaktive për të reaguar ndaj përshpejtimin konstant të ndryshimeve teknologjike dhe konkurrencës globale, BE-ja ka riafirmuar përkushtimin ndaj Shoqërisë Informative duke miratuar një kornizë të re strategjike i2010 - Shoqëria Informative Evropiane 2010, ku jepen orientime të politikave të gjera². Aty promovohet një shoqëri e hapur dhe konkurruese digjitale dhe Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (TIK) theksohet si një shtytës për përfshirje dhe për cilësi të jetesës.
- Duke pasur parasysh këtë, Kosova si një vend potenciale kandidat për aderim në Bashkim Evropian duhet të përshpejtojë procesin e ndërtimit të një shoqërie të hapur informative dhe ekonomisë së njohurive me qëllim të mbajtjes së hapit drejt integritimeve evropiane. Kosova duhet të ndjekë praktikën evropiane për shtytjen e hulumtimeve në TIK, që është një prej temave me prioritet më të lartë të Programit të Shtatë Kornizë të BE-së (FP7) për Hulumtim dhe Zhvillim Teknologjik, që gjatë periudhës 2007-2013 do të financojë hulumtime në Evropë.
- Në Raportin e Progresit të Kosovës në vitin e kaluar, Komisioni Evropian ka dhënë indikacione se "Në përgjithësi duhet të zhvillohen tutje shërbimet e shoqërisë informative". Ende mbeten për t'u implementuar strategjitë relevante dhe planet e veprimit³.

Ndikimi Ekonomik i Uljes së Tarifave Doganore dhe TVSH-së

Bazuar në përvojën e vendeve fqinje, zbatimi i normave më të ulëta të tarifave doganore dhe tatimeve nuk do të rezultojë me ulje të madhe të të hyrave tatimore nga kjo industri.⁴ Para së gjithash, Industria e TI-së dhe Shpenzimet në TI përbëjnë një pjesë të vogël të të hyrave totale në Kosovë. Sipas analizave të ndryshme të hyrat në Kosovë janë 1.19 miliard dollar amerikan (vlerësim i vitit 2007) që rezulton se të hyrat nga shpenzimet në TI janë 0.55% të të hyrave totale për vitin 2007. Kështu që, edhe nëse bëhen shkurtime të mëdha në tarifën doganore dhe TVSH, ato do të kenë efekte shumë të vogla në të hyrat e shtetit.

Pavarësisht, vendimi në lidhje me uljen e tarifave nuk duhet të bazohet vetëm në efektet e tyre fiskale. Në fakt, ky ndoshta është argumenti më i dobët për mbajtjen e qasjes "Biznesi si

² Shih, www.europe.eu.int/i2010

³ Shih Raportin e Progresit të Komisionit Evropian, **Kosovo nën UNSCR 1244/99 2009**, faqe 41
http://www.delprn.ec.europa.eu/repository/docs/ks_rapport_2009_en.pdf

⁴ Shih Arben Abdullahu, "**Raporti i Tregut të TIK-ut në Kosovë: Ndikimi i Doganës dhe TVSH-së në Tregun e TIK-ut në Kosovë**" STIKK
[HTTP://208.116.30.215/REPOSITORY/DOCS/ICT%20TRADE%20REPORT.PDF](http://208.116.30.215/REPOSITORY/DOCS/ICT%20TRADE%20REPORT.PDF)

Zakonisht". Argumenti më bindes në favor të liberalizimit të tregtisë së mallrave dhe shërbimeve duket se vjen nga përcaktimet e vendeve të rajonit për t'u bërë anëtarë të familjes evropiane.

Ndryshimet e propozuara do të kenë këto efekte:

- Do të jetë e pakuptimtë për Tregun e Zi të vazhdojnë praktikatat e kontrabandimit të mallrave në kufi.
- Tregu i TI-së do të shënojë rritje pasi që të gjitha shitjet e paregjistruara të cilat aktualisht bëhen do të shndërrohen në shitje zyrtare, e përmes kësaj edhe në shifra zyrtare statistikore.
- Zhvillimi më i madh i këtyre masave është zakonisht ndikimi në kërkesën e tregut. Një lëvizje e tillë ka ndikim të madh psikologjik në perceptimet e përgjithshme të popullatës, pasi që i bën njerëzit të ndihen se janë në hapa të njëjtë me pjesën tjetër të botës.

Rekomandimet

Bazuar në faktet e lartpërmendura, ne rekomandojmë që Qeveria duhet të ndërmarrë masat në vijim:

- Ndryshimi i Kodi të Akcizave në Kosovë duke ulur Tarifatat Doganore për mallrat dhe shërbimet e TIK-ut në 0% dhe harmonizimi me Bashkimin Evropian dhe vendet fqinje. Ne rekomandojmë që Tarifa Doganore duhet të jetë 0%.
- Amandamenti i Ligjit për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar dhe harmonizimi me TVSH-së me standardet që përdoren nga Bashkimi Evropian dhe vendet fqinje. **Ne rekomandojmë që TVSH-ja për mallrat e TIK-ut të jetë 5%.**
- Në rast se zbatohet norma e ulur e Tarifave Doganore prej 0% dhe TVSH-ja 5% atëherë rrjedha e parasë së gatshme e BKK-së vlerësohet të ulet në 3.16 milion dollar në vitin 2010, dhe gradualisht të rritet në 5.70 milion dollar në 2013.⁵

⁵ Shih Arben Abdullahu, "Raporti i Tregut të TIK-ut në Kosovë: Ndikimi i Doganës dhe TVSH-së në Tregun e TIK-ut në Kosovë" STIKK <http://208.116.30.215/repository/docs/ICT%20Trade%20Report.pdf>